

Nr. Rend or	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes
1	2/24/2026	<p>Informacion nëse zbatohet ligjit nr. 138/2015, nga ana e zyrtareve të KMSHC.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Nëse gjatë periudhës 01.09.2025 – në vijim janë nisur procedime disiplinore ndaj drejtuesve të institucionit tuaj. 2. Nëse janë marrë masa administrative ndaj tyre dhe lloji i masës (pa të dhëna sensitive personale). 3. Nëse gjatë ushtrimit të funksionit të tyre janë konstatuar raste papajtueshmërie ligjore apo konflikti interesi, të trajtuara në mënyrë institucionale. 4. Numrin e ankesave të shqyrtuara nga institucioni juaj që kanë pasur objekt vendimmarrjen e nivelit drejtues. 5. Numrin e procedurave të konkurrimit të monitoruara nga institucioni juaj ku janë konstatuar shkelje të parimeve të meritës, ligjshmërisë apo transparencës. 	3/2/2026

2	3/17/2026	Informacion nëse procedura e komandimit është në përputhje me ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe qëndrimin e institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në rast se ka shqyrtuar procedurat e ndjekura nga institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve	3/27/2026
---	-----------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------

3	4/3/2026	<p>Në vazhdimësi të informacionit të kërkuar te kërkesa për informacion me nr. rendor nr. 2 kërkesi paraqet dy pyetje për institucionin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil: 1) Ligji i jep të drejtën Komisionerit të inspektojë për çdo parregullsi me nismën e tij, pse institucioni nuk merr masa kur është realizuar një komandim i një personi pa status civil në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, 2) Nëse do të nis Komisioneri inspektim kur rasti konkret nuk ka vitet e vjetërsisë përpara futjes në konkursin e TND, për të verifikuar vlefshmërinë e aktit të emërimit.</p>	4/15/2026
4	4/27/2026	<p>Verifikim i të dhënave të punësimit të një ish punonjëse të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil</p>	4/28/2026

Komisioneri mbështetet nga Sekretariati i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit, i cili përbëhet nga Drejtori i Përgjithshëm, 5 drejtor drejtorie, 17 inspektor dhe 5 specialistë.

Të gjithë nëpunësit e mësipërm kanë statusin e nëpunësit civil dhe në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, kanë detyrimin për të dorëzuar pranë institucionit të Departamentit të Administratës Publike (DAP), formularët e vetëdeklarimit, nga data e emërimit në pozicionin përkatës të punës, ku pasqyrohet situatë personale në raport me kërkesat e këtij ligji. Aktualisht, për të gjithë punonjësit e stafit të Komisionerit (28 raste) është dërguar formulari i vetdeklarimit pranë DAP, duke përmbushur detyrimin ligjor.

Në lidhje me pyetjen e parë, nuk ka patur procedime disiplinore për periudhën 01.09.2025 dhe në vijim, për nëpunësit e kategorive të kërkuara nga ana juaj.

Në lidhje me pyetjen e dytë, nuk janë marrë masa administrative për këta punonjës.

Në lidhje me pyetjen e tretë, nuk janë konstatuar raste të papajtueshmërisë ligjore apo të konfliktit të interesit.

Në lidhje me pyetjen e katërt, nuk ka patur ankesa të shqyrtuara nga ana e institucionit të

E plotë

Në përgjigje të informacionit të kërkuar nga kërkuesi referuar dy pyetjeve të drejtuara institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil:

1. A është kjo procedurë komandimi në përputhje me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore përkatëse?
2. Cili është vlerësimi dhe qëndimi i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nëse kjo procedurë është shqyrtuar dhe konsideruar në përputhje me legjislacionin në fuqi?

Në përgjigje të kërkesës suaj, sqarojmë se, në mbështetje të kompetencave ligjore, të parashikuara në pikën 1, të nenit 11; neneve 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, veprimtari të cilën e ushtron kryesisht mbi bazën e informacioneve që vijnë nga burime të ndryshme, ose me kërkesë nga institucionet, përmes procesit të mbikëqyrjes apo inspektimit, të parashikuara në Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, të miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, e ndryshuar, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

E plotë

<p>Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, përmes postës elektronike ka administruar e-mailin e datës 30.03.2026, protokolluar pranë institucionit me nr. 452/2 prot., datë 03.04.2026, të dërguar nga kërkuesi N V, në përmbajtje të së cilit shtrohen pyetje në lidhje me administrimin e marrëdhënies së punësimit të E. L.</p> <p>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se, më parë Komisioneri ka administruar e-mailin e datës 16.03.2026, të dërguar nga kërkuesi N.V, protokolluar pranë tij me nr. 452 prot., datë 17.03.2026, në përmbajtje të së cil it ngrihen të njëjtat pretendime dhe i ka trajtuar ato në mënyrë shteruese me shkresën nr. 452/1 prot., datë 27.03.2026, “Kthim përgjigje informacionit të administruar pranë Komisionerit me shkresën nr. 452 prot., datë 17.03.2026, të dërguar nga N:V.”, në të cilën Komisioneri ka evidentuar se procedura e pranimi në TND organizohet nga Departamenti i Administratës Publike.</p> <p>Referuar informacionit të administruar përmes e-mailit të datës 14.04.2026, të dërguar nga DAP, në të cilin Komisioneri është për dijeni, konstatohet se, ky institucion ju ka sqaruar me hollësi procedurën e ndjekur për rastin e emërimit të nëpunëses E. L.</p>	<p>E plotë</p>
<p>Kërkuesi kërkon të verifikojë të dhënat e punësimit të mëparshëm të një ish punonjëse L.DH të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.</p>	<p>E plotë</p>

	Tarifa
	Nuk ka

	Nuk ka
--	--------

	Nuk ka
	Nuk ka